

# Probleme pa zgjidhje?



## Probleme pa zgjidhje?

Raport i shkurtër mbi natyrën e problemeve në  
komunat e Kosovës

—  
Maj 2019

## — Përmbajtja

### 3 Hyrje

4 Llojet e problemeve të identifikuar nëpër komuna

6 Problemet e identifikuar dhe premtimet në fushatë zgjedhore

8 Problemet e identifikuar dhe planifikimet buxhetore të komunave

9 Problemet e komunave dhe shërbimet publike

10 Përfundim

## Hyrje

Shumë herë problemet më të mëdha me të cilat përballen banorët e komunave të Kosovës nuk përputhen me ofertën zgjedhore të kandidatëve për kryetar komunash. Kjo ndodh për shkak se partitë politike dhe kandidatët për kryetarë nuk kryejnë hulumtime për të matur shqetësimet kryesore të qytetarëve të cilët synojnë t'i qeverisin.

Për të mbushur këtë boshllëk në mes të problemeve kryesore të qytetarëve dhe ofertave zgjedhore të kandidatëve për kryetar komunash, para fushatës zyrtare zgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2017, ashtu sikurse edhe më 2013, Instituti GAP ka identifikuar problemet kryesore në 30 komuna të Kosovës.

Problemet e identifikuar, së bashku edhe me kapacitetet buxhetore të komunave për periudhën afatmesme (2019-2021), janë publikuar në 30 raporte dhe u janë shpërndarë kandidatëve për kryetar të komunave, mediave dhe organizatave lokale të shoqërisë civile.<sup>1</sup>

Në 30 komuna janë identifikuar 181 probleme të ndryshme. Për t'i identifikuar këto probleme, para zgjedhjeve lokale të vitit 2017, Instituti GAP ka intervistuar përfaqësues të organizatave jo qeveritare nëpër komuna, ekspertë dhe njohës të zhvillimeve lokale, përfaqësues të mediave, këshilltarë komunal të partive të ndryshme të përfaqësuara në legjislativin e komunës, përfaqësues të këshillave të fshatrave dhe lagjeve. Po ashtu një pjesë e të dhënave u janë referuar procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendeve komunale.

Problemet e identifikuar bien në fushën e infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë, shërbimeve publike, trashëgimisë kulturore, urbanizimit, etj. Problemet si papunësia, varfëria, siguria dhe mungesa e energjisë elektrike, ndonëse llogariten si probleme madhore me të cilat përballën qytetarët e Kosovës, nuk janë përfshirë në raportet për problemet e komunave, ngase llogariten si përgjegjësi që u takojnë institucioneve të nivelit qendror.

Në këtë raport të shkurtër janë pasqyruar të dhëna se sa nga 181 problemet e identifikuar nga Instituti GAP para fushatës zgjedhore të vitit 2017, kanë arritur të përfshihen në programet zgjedhore të kryetarëve aktual të komunave, ose për sa prej tyre janë dhënë premtime se do të adresohen gjatë debateve zgjedhore. Po ashtu, raporti do të tregojë statusin e këtyre problemeve të identifikuar, një vit e gjysmë pas identifikimit të tyre. Në fund, problemet e identifikuar do të trajtohen kundrejt kapaciteteve buxhetore të komunave dhe përzierjes së kompetencave në mes të nivelit qendror dhe lokal.

<sup>1</sup> Instituti GAP. Raportet. 2017. Burim: <https://bit.ly/2zwcYlr>


## Llojet e problemeve të identifikuara nëpër komuna

Nëse i grupojmë 181 problemet e identifikuara sipas fushave, del se problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët kanë të bëjnë me arsimin, furnizimin me ujë të pijes, ndriçimin publik dhe çështjet mjedisore. Pothuajse në të gjitha komunat është identifikuar së paku një problem që ka të bëjë me ndotjen e mjedisit. Nëse në ndotje të mjedisit përfshijmë problemet si ndotja akustike (zhurma), problemet mjedisore që shkaktojnë gurëthyesit, ndotja e ajrit, mbeturinat, ujërat e zeza, ndotja e shtretërve të lumenjve dhe problemet me hidrocentralet, atëherë problemet mjedisore janë problemet me frekuencën më të lartë të hasura në komuna.

Problem tjetër i hasur në komuna është furnizimi me ujë të pijes. Në 50% të komunave ku është kryer hulumtimi del se aspekte të ndryshme të furnizimit me ujë të pijes, si mungesa e burimeve të ujit, cilësia e ujit, gypat e vjetërsuar ose të asbestit, mungesa e rrjetit në fshatra, etj., janë shqetësim për qytetarët.

Pas problemeve mjedisore dhe mungesës së ujit të pijes, radhiten problemet në arsim, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukturën shkollore, pastaj problemet në shëndetësi dhe ndriçimi publik.

**Grafikoni 1.** Grupimi sipas fushave i problemeve më të mëdha nëpër komuna



Në frekuencë më të vogël janë shfaqur problemet si infrastruktura rrugore, mungesa ose uzurpimi i trotuareve, rreziku nga qentë endacak, degradimi i tokës bujqësore, mungesa e parqeve ose hapësirave të gjelbëruara, etj.

Tabela 1. Problemet sipas komunave

Komuna	Problemet e furnizim me ujë	Arsim	Hidrocentrallet	Infrastrukturë rrugore	Strukturat paralele	Shëndetësi	Mungesa e trotuareve	Menaxhimi i mbeturinav	Hekurudha	Prerja e pyjeve	Mungesa e parkingjeve	Ujërat e zeza	Ndotja e lumenjve	Ndërtimet ilegale	Mirëmbajtja e objekteve	Zhurma	Transporti publik	Qentë endacak	Mungesa terr. sportive	Ndotja e ajrit	Investimet në turizëm	Stacioni i Autobuseve	Mungesa e ndriçimitpublik	Shkatërrimi i tokës bujqësore	Gurëthyesit	
Deçan	■	■	■	■						■																
Dragash	■	■	■	■	■																					
Drenas		■				■	■																			
Ferizaj	■					■		■	■	■	■	■														
F. Kosovë		■				■							■	■	■											
Gjakovë								■				■				■	■									
Gjilan		■		■				■				■														
Graçanicë				■	■						■	■	■					■	■							
Hani Elez.	■	■				■					■	■	■							■		■				
Istog								■		■		■	■													
Junik		■						■		■											■	■				
Kaçanik	■	■		■								■		■				■					■			
Kamenicë	■	■										■		■										■		
Klinë	■	■									■	■	■												■	
Lipjan	■											■	■		■											
Malishevë												■	■						■				■		■	■
Mitrovicë		■						■			■		■					■			■		■			
Novobërd	■					■						■	■								■					
Obiliq								■				■	■					■		■	■					
Pejë		■						■			■		■	■												
Podujevë	■					■		■				■	■					■								
Prishtinë		■						■							■	■	■				■					
Prizren							■						■													
Rahovec	■	■																				■	■	■		
Shtërpcë		■									■		■						■		■					
Shtime												■										■				■
Skenderaj	■							■				■	■						■				■			
Suharekë	■						■			■			■										■			
Viti	■	■				■						■	■						■				■			
Vushtri	■										■	■	■													

\*Fushat me ngjyra paraqesin prezencën e problemit në atë komunë

Nga kjo tabelë shihet se komunat me territor të pasur malor kanë njëkohësisht edhe problemin e prerjes së pyjeve. Këtë shqetësim e kanë sidomos komunat e rajonit të Dukagjinit (Peja, Deçani, Juniku, Istogu).

Por janë disa probleme të cilat janë të ndërlydhura. Për shembull, ka një ndërlydhje në mes të problemit me mbeturina, ujërave të zeza dhe ndotjes së lumenjve. Mungesën e kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza dhe mos trajtimin e mbeturinave e vuajnë më së shumti shtretërit e lumenjve, kundërmimi i të cilave pastaj ndot ajrin dhe shkakton probleme për banorët që jetojnë afër shtretërve të lumenjve.

## Problemet e identifikuarra dhe premtimet në fushatë zgjedhore

Edhe pse qëllimi i identifikimit të problemeve madhore në secilën komunë ka qenë që ato probleme të ndërlydhen me programet zgjedhore dhe pastaj të reflektohen në planet qeverisëse të kryetarëve të komunave, prapë se prapë një pjesë e madhe e problemeve të identifikuarra kanë mbetur jashtë premtimeve zgjedhore dhe jashtë planit qeverisëse. Kjo vërejtje rezultoi si rezultat i asaj se kandidatët dhe partitë politike nuk marrin parasysh hulumtimet e organizatave jo qeveritare dhe nuk kryejnë hulumtime vetanake për identifikimin e problemeve.<sup>2</sup>

Nga 181 problemet e identifikuarra në 30 komuna, kryetarët aktual të komunave gjatë fushatës zgjedhore kanë dhënë premtime për t'i adresuar 52 nga problemet e identifikuarra apo 29%. Vetëm kryetari i Komunës së Gjakovës ka adresuar të gjitha problemet e identifikuarra. Kryetarët e komunave Drenas, Viti, Prizren, Kamenicë dhe Lipjan kanë adresuar së paku gjysmën e problemeve të identifikuarra nga Instituti GAP.

Kryetarët e komunave Graçanicë, Shtërpçë, Skenderaj dhe Novobërdë nuk kanë pasur program zgjedhor dhe nuk kanë marr pjesë në debatet zgjedhore. Tabela 2 pasqyron problemet e identifikuarra nga Instituti GAP para fushatës zgjedhore dhe premtimet e dhëna për adresimin e atyre problemeve.

Nga 52 problemet e identifikuarra e për të cilat kryetarët e komunave kanë dhënë premtime se do t'i zgjidhin gjatë mandatit qeverisëse, në vitin e parë të mandatit janë përmbushur tetë, kurse janë iniciuar apo janë afër përmbushjes 33 premtime të ndërlydhura me problemet e identifikuarra.<sup>3</sup>

2 Gjatë fushatës zgjedhore, kandidatët të shumtë të partive të ndryshme të cilët kanë garuar për kryetarë komunash kanë përdorur të gjeturat e Institutit GAP gjatë fushatës, por në këtë analizë jemi fokusuar vetëm tek premtimet e atyre kandidatëve që kanë fituar garën zgjedhore.

3 Të gjithë premtimet e kryetarëve të komunave dhe progresin në realizimin e tyre mund ti gjeni në këtë vegëz <https://bit.ly/2kafNOV>

**Tabela 2. Problemet dhe premtimet e kryetarëve të zgjedhur të komunave**

Problemet e identifikuara para fushatës zgjedhore dhe premtimet e kryetarëve të zgjedhur.

- Numri rendor paraqet radhitjen e problemeve të identifikuara nga GAP<sup>3</sup>;
- Ne ngjyrë të gjelbër janë shënuar problemet për të cilat ka premtime se do të zgjidhen;
- Me ngjyrë të kuqe janë shënuar problemet për të cilat kryetarët aktual nuk i kanë adresuar gjatë fushatës zgjedhore;
- Me \* janë shënuar komunat në të cilat kryetarët aktual nuk kanë prezantuar program zgjedhori dhe nuk kanë marr pjesë në debate zgjedhore.

Komuna	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Deçan	■	■	■	■	■	■									
Dragash	■	■	■	■	■										
Drenas	■	■	■	■	■	■	■	■							
Ferizaj	■	■	■	■	■	■	■								
F.Kosovë	■	■	■	■	■	■	■								
Gjakovë	■	■	■	■											
Gjilan	■	■	■	■	■	■									
Graçanicë*	■	■	■	■	■	■	■								
Hani Elez.	■	■	■	■	■										
Istog	■	■	■	■	■										
Junik	■	■	■	■	■										
Kaçanik	■	■	■	■	■	■									
Kamenicë	■	■	■	■	■	■									
Klinë	■	■	■	■	■										
Lipjan	■	■	■	■											
Malishevë	■	■	■	■	■										
Mitrovicë	■	■	■	■	■	■	■								
Novobërd*	■	■	■	■	■										
Obiliq	■	■	■	■	■										
Pejë	■	■	■	■	■										
Podujevë	■	■	■	■	■	■									
Prishtinë	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Prizren	■	■	■	■	■	■									
Rahovec	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■				
Shtërpcë*	■	■	■	■	■										
Shtime	■	■	■												
Skenderaj*	■	■	■	■	■	■									
Suharekë	■	■	■	■	■										
Viti	■	■	■	■	■	■	■	■							
Vushtrri	■	■	■	■	■	■									


4 Të gjitha raportet e Institutit GAP me problemet e identifikuara në komuna mund t'i gjeni në këtë link <https://bit.ly/2zwcYlr>

## Problemet e identifikuar dhe planifikimet buxhetore të komunave

Në bazë të Ligjit për Buxhetin për vitin 2019<sup>5</sup>, investimet kapitale për vitin aktual dhe dy vitet në vazhdim (2019-2021) kapin shumën totale prej 537.6 milionë eurove. Njësoj sikur edhe në vitet e mëparshme, pjesa më e madhe e buxhetit investohet në infrastrukturë rrugore (27%), ani pse infrastruktura rrugore nuk është problemi kryesorë i identifikuar nga qytetarët. Edhe pse furnizimi me ujë të pijes është problem mjaft i madh për qytetarët e Kosovës, vetëm 2% e buxhetit të të gjitha komunave do të investohet në ujësjellës për tri vite.

Njësoj, edhe pse menaxhimi i mbeturinave është shqetësim i madh për qytetarët, komunat kanë ndarë vetëm 1% të buxhetit për rregullimin e infrastrukturës e cila mundëson grumbullimin e mbeturinave. Në përgjithësi, për problemet e mjedisit (mbeturina, hapësira të gjelbëruara, kanalizimi i ujërave të zeza, rregullimi i shtretërve të lumenjve) janë ndarë vetëm 14% e buxhetit, përderisa kategoria e mjedisit përbën mbi 50% të problemeve të identifikuar nga qytetarët nëpër komuna.

**Grafikoni 2. Buxheti për investime kapitale të komunave për periudhën 2019-2021 krahas problemeve më të mëdha të komunave**



Një numër i konsiderueshëm i problemeve nëpër komuna mund të zgjidhen pa pasur nevojë për ndarje të veçantë buxhetore. Problemet si operimi i taksive ilegal, ekspozimi i mallrave ushqimorë në vendet pa kushte teknike/higjienike, ndalja e ndërtimeve pa leje, mbrojtja e zonave historike, evitimi i rasteve të zhurmës gjatë natës, zvarritja e projekteve investuese, prezenca e shitëseve ambulant në sheshe, bllokimi i trotuareve nga automjetet, apo reklamat e ndryshme të bizneseve në hapësirat publike, janë disa nga problemet që zgjidhja e tyre nuk kërkon buxhet shtesë.

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.06/L-133 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Burimi: <https://bit.ly/2Pv2LT1>



## Problemet e komunave dhe shërbimet publike

Menaxhimi i mbeturinave dhe furnizimi me ujë të pijes janë probleme për të cilat qytetarët kërkojnë zgjidhje nga kryetarët aktual. Por, menaxhimi i mbeturinave dhe menaxhimi i rrjetit të ujësjellësit nuk janë kompetencë ekskluzive e komunave.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, furnizimi me ujë është kompetencë e komunave. Por, në praktikë, furnizimi me ujë bëhet nga kompanitë rajonale të ujësjellësve, aksionar i së cilave është Ministria e Zhvillimit Ekonomik në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike. Në Kosovë funksionojnë shtatë kompani rajonale të ujësjellësit (KRU) të cilat ofrojnë shërbime për komuna apo rajone të ndryshme të Kosovës.

Edhe menaxhimi i mbeturinave është kompetencë vetanake e komunave sipas nenit 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Por në praktikë, më shumë se kompetencë vetanake, menaxhimi i mbeturinave bie në kompetencë të kompanive rajonale të cilat funksionojnë si shoqëri aksionare. Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, ekzistojnë 11 kompani të mbeturinave, në pesë prej të cilave komunat kanë pronësi 100% (Gjakova, Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku), kurse kompanitë tjera janë kompani rajonale, bordi i të cilave përbëhet nga dy e më shumë komuna.<sup>6</sup>

Andaj, më shumë se sa ndarje të buxhetit, zgjidhja e problemit të mbeturinave dhe furnizimit me ujë të pijes kërkon bashkëpunim më të mirë në mes të pushtetit qendror dhe lokal, si dhe ndryshim të mënyrës së menaxhimit të ndërmarrjeve publike.

Përveç furnizimit me ujë dhe menaxhimit të mbeturinave, ndërthurja e kompetencave në mes të pushtetit lokal dhe qendror krijon pengesa në adresimin e problemeve edhe sa i përket ndotjes së ajrit, ruajtjes së pyjeve, personelit në arsim, zhvillimit ekonomik lokal, etj.

<sup>6</sup> Për më shumë informata për problemin e bashkëpunimit mes komunave dhe nivelit qendrorë, mund të gjeni në raportin e Institutit GAP "Sa kanë kompetenca vetanake komuna?". Burimi: <https://bit.ly/2Dy74hM>

## Përfundim

Ky raport edhe një herë dëshmon se ka një mospërputhje të madhe mes shqetësimeve kryesore të qytetarëve, ofertës zgjedhore të partive politike, si dhe programeve qeverisëse dhe mënyrës se si shpenzohet buxheti për investime kapitale.

Kjo mospërputhje në mes të problemeve të qytetarëve dhe ofertave qeverisëse të kryetarëve të komunave ndikon që problemet madhore të komunave të mos zgjidhen me vite të tëra, ashtu siç ka ndodhur me shumë probleme nëpër komuna.

Disa nga problemet e identifikuar nga Instituti GAP kërkojnë zgjidhje përmes investimeve kapitale. Por janë një sërë problemesh, zgjidhja e së cilave varet vetëm nga zbatimi i ligjeve nga komunat, pa pasur nevojë për buxhet shtesë.

Ndërthurja në kompetenca në mes të nivelit qendror dhe lokal dhe mos-komunikimi i duhur në mes të pushteteve, në shumë raste, ka penguar komunat në zgjidhjen e problemeve. Në disa raporte të mëhershme të Institutit GAP, është ngritur shqetësimi për konfliktin e kompetencave dhe mos zbatimin e duhur të ligjeve nga komunat. Andaj, nevojiten ndryshime ligjore me qëllim që komunat të kenë kompetenca më të mëdha qeverisëse, si dhe të ketë një ndarje asimetrike të kompetencave për komunat të cilat tregojnë zotësi më të madhe në qeverisje.

Kandidatët për kryetar komunash dhe partitë politike që synojnë përfaqësimin në organet qeverisëse lokale nevojitet që të ngritin kapacitetet sa i përket identifikimit të problemeve reale të komunave me të cilat synojnë të qeverisin dhe t'i adresojnë ato në programet zgjedhore. Është shumë shqetësuese se një pjesë e konsiderueshme e kandidatëve për kryetar të komunave nuk kanë programe zgjedhore, si dhe refuzojnë të marrin pjesë në debatet publike zgjedhore. Kjo ka pamundësuar edhe punën tonë në identifikimin e premtimeve për kryetarët e disa komunave dhe monitorimin e punës së tyre.

Është inkurajuese që ka një ngritje të vetëdijesimit të qytetarëve për qeverisjen dhe punën e të zgjedhurve në nivel lokal. Kjo ngritje e vetëdijesimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në dy palë zgjedhjet e fundit lokale është manifestuar edhe me votë ndëshkuese për kryetarët dhe partitë qeverisëse, ku qeverisja është ndërruar në shumicën e komunave. Andaj, kandidatët për kryetar komunash dhe kryetarët aktual duhet të fokusohen në adresimin e problemeve kryesore me të cilat përballen qytetarët.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt është mbështetur nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller  
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

## **Probleme pa zgjidhje?**

Raport i shkurtër mbi natyrën  
e problemeve në komunat e Kosovës